

# AKTI I THEMELIMIT

## I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### “4 DIM” SH.P.K

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, sot më datë 10.05.2019, anëtarët e poshtëshënuar:

1. **Z. Oltion Raveli**, shtetas shqiptar, lindur më 08.02.1977, në Berat, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Psaportes me Nr.BI0684182 dhe Nr. Personal: H702307060F, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. **Z. Klodian Gumeni**, shtetas shqiptar, lindur më 29.07.1978, në Gjirokastrë, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. personal: H80729024U, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
3. **Z. Bilbil Zeneli**, shtetas shqiptar, lindur më 07.06.1982, në Erseke, Kolonje, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: I206071680, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kanë vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm, për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj.

### NENI 1


#### EMËRTIMI I SHOQËRISË

- 1.1. Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “**4 DIM**” SH.P.K., në vijim referuar si “*Shoqëria*”.

### NENI 2

#### BAZA LIGJORE

- 2.1. *Shoqëria* do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 2.2. Kjo *Shoqëri* fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.



### NENI 3 SELIA

- 3.1 Selia kryesore e aktivitetit të *Shoqërisë* është në adresën: Rruga “Gjon Krisili, Ndertesa 64”, Tiranë, Shqipëri.

### NENI 4 OBJEKTI

- 4.1. Objekti kryesor i veprimtarisë së *Shoqërisë* përfshin sa më poshtë vijon:

- Ndërtime, rikonstruksione dhe mirembajtje të objekteve civile, industriale, tregtare, turistike, shëndetësore, kulturore, sportive, vepra kullimi për vaditje, infrastrukture, shërbime komunale e urbane, ndërtime rrugore e hekurudhore, projektme të objekte të sipër treguara, blerje dhe shitje trojesh, ndërtesa dhe pasuri të paluajtshme.
- Ndërtim të strukturave metalike komplekse të tilla si: porte, stadione, qendra tregtare, parqe logjistike, parqe industriale, fabrika, kabanone, hangarë, etj
- Ndërtim pasurish të patundshme për banim; Ndërtime investimesh publike dhe veprash arti-ura autostrada.
- Konstruksione karpjenterie, hekurkthyes etj.
- Kryerjen e ndërtimeve civile dhe rrugore, ndërtimin për llogari të vet ose të tretëve të ndërtimeve industriale, bujqësore, kryerjen e infrastrukturës urbanistike, të parcelimit, kryerja e punimeve të rrugëve, ujësjellësve, rrjetit të kanalizimeve, gazsjellësve, impiante elektrike, civile dhe industriale, kryerje e punimeve në rrjetet e shpërndarjes së energjisë elektrike private dhe publike. Instalim të impianteve termohidraulike. Rikonstruksion i pasurisë publike, asfaltime duke përfshirë dhe ato të tarracave dhe hidroizolimim e tyre.
- Marrja përsipër e sipërmarrjeve publike dhe private të çdo lloji. Gërmime dheu. Gërmime dheu me punime eventuale murature dhe betonarme. Prishja dhe punime në tokë të gërmuar.
- Restaurimi i ndërtesave dhe monumenteve të kulturës. Punime në sipërfaqe të gjelbërta, parqe dhe pyje. Mirëmbajtja, zhvillimi i dekorit në mjedise urbane.
- Konsulence, manaxhim, projektim, auditime teknike dhe studime fizibiliteti ne fushen e ndertimit.
- Konsulencë Financiare, Analize dhe vleresim te biznesit, i strukturave operative financiare per industri te ndryshme financimeve te ndryshme, modelim i biznesit, keshillime mbi ristrukturimin e organizimin financiar, studime tregu, studime plan biznesi, transaksionet dhe strategjine e shitjeve, keshillime mbi partnershipe te ndyshme,

negocime te termave te marreveshjes, vleresime risku dhe keshillime per mitigimin e tyre.

Shoqëria mund të kryej edhe çdo lloj aktiviteti tjetër ndihmës dhe të nevojshëm që ka lidhje të mjaftueshme me këtë objekt aktiviteti dhe që nuk bie ndesh me ligjet shqiptare në fuqi.

## **NENI 5 KOHËZGJATJA**

**5.1.** Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është me afat të pacaktuar.

## **NENI 6 KAPITALI THEMELTAR**


**6.1.** Kapitali themeltar i Shoqërisë është 120.000 (njëqind e njezete mijë) Lekë, tërësisht i nënshkruar dhe i pashlyer nga Ortakët Themelues të shoqërisë përpara regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

**6.2.** Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 3 (tre) kuota, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri.

**6.3.** Pjesët e kapitalit zotërohen nga ortakët si më poshtë:

- a) Ortaku Oltion Raveli sh.p.k zotëron 33.33% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të shoqërisë ose 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me 40.000 Lek (Dyzete mijë).
- b) Ortaku Klodian Gumeni zotëron 33.33% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të shoqërisë ose 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me 40.000 Lek (Dyzete mijë).
- c) Ortaku Bilbil Zeneli sh.p.k zotëron 33.33% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të shoqërisë ose 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me 40.000 Lek (Dyzete mijë).

## **NENI 7 TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR**



The image shows three distinct blue ink signatures, likely belonging to the founders mentioned in the text: Oltion Raveli, Klodian Gumeni, and Bilbil Zeneli. The signatures are written in a cursive style and are positioned below the 'NENI 7' section header.

- 7.1. Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara në Statutin e shoqërisë dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

## NENI 8 ADMINISTRIMI

- 8.1. Emërohet Administrator i *Shoqërisë Z. Klodian Gumeni*, shtetas shqiptar, lindur më 29.07.1978, në Gjirokaster, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. personal: H80729024U, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 8.2. Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe Statutit të shoqërisë.
- 8.3. Administratori është i autorizuar të veprojë në emër të *Shoqërisë* në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe ka të drejtë t’i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.
- 8.4. Administratori do të qëndrojë në detyrë për 5 (pesë) vjet dhe gëzon të drejtën e riemërimit në këtë detyrë pas përfundimit të mandatit të tij.

## NENI 9 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

- 9.1. Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statutin e *Shoqërisë* si dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 9.2. Ky Akt Themelimi është hartuar në Tiranë, Shqipëri në 5 (pesë) kopje origjinale në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha të njëjtën fuqi ligjore.

## O R T A K Ë T

Z. Oltion Raveli



Z. Klodian Gumeni



Z. Bilbil Zeneli

